

28 - 09 - 2018

P.nr. 2630/17

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja Hysnije Gashi si dhe zyrtarja ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II nr.2046-5 të datës 23.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, përfaqësuesi juridik i të dëmtuarës DBP-Ferizaj dhe të pandehurit [REDACTED], me datë 28.08.2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 30.08.2018 përpiloj me shkrim këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, i lindur më [REDACTED] në të njëtin vend, nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED], e vajzërisë [REDACTED] i martuar, babë i dy fëmijëve punëtorë fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. Personal [REDACTED]

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 10.09.2017 rrëth orës 17-00, në pyllin publik ne vendin e quajtur "Finishta" në Rajonin Ekonomiko Pyjorë Neredime – Jezerc, është takuar duke prerë 1 copë trungu të llojit ahu të njomë, me diametër 80 cm, , me vëllim te përgjithshëm prej 5.85 metra kub e në vlerë prej 789.75, ,drunjtë kanë qenë të prerë me sharrë motorike dhe të transportuara me traktor.

-më këtë ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartëkur dhe neneve 4,7,17,21,49,50,51 të KPRK-së të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e

## GJY K O N

- DENIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 4(katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 /një/ vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetë.

- DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200/ dyqind euro/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nëse dënim i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj nga një ditë burgimi

Obligohet i akuzuari që në emër të pashallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njëzet/€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimtit shumën prej30 /tridhjetë/€ në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara DBP- në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.2046-5/17 të datës 23.10.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDACTED] për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale e mbajti shqyrtimin fillestar me datë 21.12.2017 dhe shqyrtimin gjyqësor më datë 28.08.2018, në të cilën përfaqësuesi i akuzës – Prokurori i Shtetit - lexoj aktin akuzues dhe në fjalën e tij përfundimtare ka mbetë në tërësi pranë akuzës, njëherit ka kërkuar nga gjykata të njëtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi u bind se i pandehuri ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 të KPPK-së të akuzuarit i ofroi mundësin të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

Përfaqësuesi juridik i të dëmtuarit [REDACTED] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare te Prokurorit të Shtetit dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

I pandehuri [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale me të cilën është ngarkuar, duke shtuar se posedon zabelin e tij privat dhe me dru furnizohet nga zabeli i tij po ashtu ka shtuar se e njeh pylltarin [REDACTED] [REDACTED] mirëpo nuk i kujtohet se e ka takuar ditën kritike në vendin e quajtur ‘Firishta’

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetoj gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoj nga dëshmia e të dëshmitarit – pylltarit [REDACTED], i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: se punon si roje pylli në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj , rajoni Neredime/Jezerc, dhe ditën kritike e ka takuar të akuzuarin [REDACTED] të cilin e njeh shume mire në vendin e quajtur “Firishta” në Rajonin Ekonomiko Pyjorë Neredime – Jezerc, duke prerë 1 lis te të llojit ahu të njomë , me diametër 84 cm, , me sharrë motorike të cilat i ka transportuar me traktor IMT.

Gjykata dëshmisë së dëshmitarit ia shprehi besimin e plotë, pasi që të njëjtat janë të mbështetura në prova dhe fakte të cilat janë administruar në cilësinë e provës sic janë:  
-fletëparaqitja e rojës së pyllit me vlerësim dhe llogaritjen e dëmit të pyllit me nr.647/2017 e datës 25.09.2017

Pra gjykata në bazë të gjitha provave të rastit dhe në bazë të deklarimeve të dëshmitarit ka vërtetuar gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe se ka vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK –së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit nenit 73 të KPK-së, si rrrethana veçanërisht lehtësuese gjykata mori gjendjen e varfër të pandehurit, si dhe rrrethana e tij familjare, ndërsa rrrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, përvç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Në bazë të këtyre rrrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësish i justifikueshëm dhe në proporcione me peshën e veprës konkrete penale, rrrethana të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri.

E dëmtuara konform nenit 458, 459 dhe 460 të KPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.


Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njëzet/€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimate të krimít shumën prej 30 /tridhjetë/€ në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P.nr.2630/17 të dt.30.08.2018**

Zyrtare ligjore,  
Albana Ujupi

Gjyqtaria,  
Hysnije Gashi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit Kosovës. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.